



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI**

**L I G J**

**Nr. 169/2013**

**PËR**

**“PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 160, DATË 15.10.2009 “PËR RREGULLIMIN  
E SHËRBIMIT TË TRANSPORTIT PËR FUNKSIONARËT PUBLIK DHE NËPUNËSIT  
CIVILË”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Keshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

**VENDOSI:**

Në ligjin nr.10160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publik dhe nëpunësit civilë”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 2, pika 2, ndryshohet si më poshtë vijon:

*“Kategoria e dytë, ku përfshihen të gjithë funksionarët e përcaktuar në lidhjen 2, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij, të cilëve u caktohet një përfitim maksimal financiar mujor, sipas vlerës së përcaktuar në po këtë lidhje, për shërbime transporti, në përmbushje të detyrave të tyre funksionale. Masa e përfitimit financiar mujor për çdo deputet përcaktohet në bazë të distancës me zonën që ai përfaqëson, por, kjo masë nuk mund të jetë më shumë se 40 000 (dyzet mijë) lekë në muaj dhe miratohet me vendim të Kuvendit.”*

Pikat 3 dhe 4 të nenit 2 të ligjit, shfuqizohen.

Neni 2

Neni 5 i ligjit, shfuqizohet.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare” dhe i shtrin efektet financiare pas hyrjes në fuqi të tij.

**ILIR META**

**KRYETAR I KUVENDIT**

Lidhja nr. 2: Për përfitimin financiar mujor të shërbimit të transportit për disa funksione publike

Nr	Funksionet përfituese të kategorisë së dytë	Përfitimi maksimal financiar mujor në lekë
1	Deputet	40.000
3	Kryetar i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare	20.000
4	Kryetar i Autoritetit të Konkurrencës	20.000
5	Kryetar i Komisionerit të Mbrojtjes së të Dhënave Personale	20.000
5	Kryetar i Komisionerit të Mbrojtjes nga Diskriminimi	20.000
6	Kryetar i Komisionit të Shërbimit Civil	20.000
7	Kryetar i Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit	20.000
8	Kryetar i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare	20.000
9	Kryetar i Entit Rregullator të Energjisë	20.000
10	Kryetar i Entit Rregullator të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura	20.000
11	Kryetar i Inspektoratit të Deklarimit të Pasurive	20.000
12	Kryetar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve	20.000
13	Zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë	20.000
14	Zëvendësministër	15.000